

**A K T - T H E M E L I M I**  
**( K O N T R A T Ë )**  
**P È R**  
**THEMELIMIN E SHOQËRISË TREGTARE ME**  
**PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“ALBO DISTRIBUTION” SH.P.K**

Bazuar në ligjin 9901 dt 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqeritë tregtare” i ndryshuar nëpërmjet Ligjit 129/2014 datë 02.10.2014, dhe të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore, që rregullojnë fushën e rregjistrimit, liçensimit dhe funksionimit të subjekteve tregtare në Republikën e Shqipërisë, në Tiranë, sot, më datë 27.01.2025, unë Xhenis Mazreku, lindur në Tiranë, më 24.05.1987 dhe banues në Tiranë, shtetas Shqiptar, mbajtës i Pasaportës/ID me nr: I75524052E, madhor e me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, dhe unë Kristofor Harito, lindur në Tiranë, më 02.04.1987 dhe banues në Tiranë, shtetas Shqiptar, mbajtës i Pasaportës/ID me nr: I70402076T, madhor e me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me vullnetin tonë të lirë, në cilësinë e ortakëve themelues, pasi themeluam shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “ALBO Distribution” SH.P.K shpallim statutin e shoqërisë tregtare si më poshtë vijon:

**FORMIMI  
Neni 1**

Formohet shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “**ALBO Distribution**” SH.P.K me dy ortak themelues:

- Xhenis Mazreku, lindur në Tiranë, më 24.05.1987 dhe banues në Tiranë, shtetas Shqiptar, mbajtës i Pasaportës/ID me nr: I75524052E.
- Kristofor Harito, lindur në Tiranë, më 02.04.1987 dhe banues në Tiranë, shtetas Shqiptar, mbajtës i Pasaportës/ID me nr: I70402076T.

**Neni 2**

Shoqëria tregtare “**ALBO Distribution**” SH.P.K do të ketë selinë në: Njësia Bashkiake Nr. 5, Rruga Brigada VIII Pall Teknoprojekt 2001, Shkalla 1, Tiranë.

Veprimtaria e saj do të jetë me kohë të pacaktuar.

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj ekonomike në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe në cdo shtet tjeter të huaj, me miratimin e asamblesë së përgjithshme të ortakëve dhe në përputhje me ligjet e vendit apo shtetit përkatës ku do ta ushtrojë këtë veprimtari, duke zbatuar të gjitha dispozitat ligjore të vendit ku do të ushtrojë veprimtarinë e saj.

### Neni 3

Shoqëria është person juridik shqiptar.

Veprimtaria e saj zhvillohet sipas dispozitave të legjisacionit shqiptar, sipas kësaj kontrate dhe statutit të shoqërisë te cilat janë akte ligjore të pandashme.

Shoqëria është me përgjegjësi të kufizuar dhe përgjigjet vetëm për pasurinë e saj dhe në asnjë rast nuk përgjigjet për detyrimet e ortakut/ortakëve jashtë kushteve të kësaj kontrate. Gjithashtu dhe ortaku/ortakët nuk përgjigjen personalisht për detyrimet e shoqërisë dhe nuk ngarkohen në asnjë rast për detyrimet jashtë kuotës së tyre në krijimin e shoqërisë, apo asaj që do të posedojnë në të ardhmen, përvèç rasteve kur ai/ata vullnetarisht marrin përsipër për një gjë të tillë.

### OBJEKTI I VEPRIMTARISË

### Neni 4

Objekti i veprimtarisë së shoqërise tregtare “**ALBO Distribution**” SH.P.K është:

- Produkte hotelerie dhe produkte pastrimi. Tregëti me pakicë të artikujve të ndryshëm industrial, veshmbathje, makinerive, mobiljeve, artikujve kozmetike te perpunuara dhe te paperpunuara, bime medicinale, paisjeve elektrosh tepiake, elektrike, elektroteknike. Realizimin dhe drejtimin e strukturave te tillë si: hotel, bare, restorante.

Veç sa më sipër në shoqëri do të zhvillohet çdo aktivitet tjeter që vetëm ose së bashku me veprimtarinë kryesore të lartpërmendur, do të vlerësohen si të favorshme për zhvillimin, forcimin dhe rritjen e gjendjes ekonomike e financiare të saj.

### Neni 5

Kapitali themelor i shoqërise është caktuar në shumën 100.000 lekë dhe përbëhet nga 2 kuotë me vlerë nominale totale prej 100.000 lekë.

Kapitali themelor, kontribuohet prej ortakut themelues, i takon ortakut si më poshtë:

- Ortaku, Xhenis Mazreku kontribuon, dhe posedon 1 kuotë me vlerë nominale 51.000 lekë, me perqindje ne pjesemarrje 51% te kapitalit total te shoqerise.
- Ortaku, Kristofor Harito kontribuon, dhe posedon 1 kuotë me vlerë nominale 49.000 lekë, me perqindje ne pjesemarrje 49% te kapitalit total te shoqerise.

Ortaku i shoqërisë do të derdhi në llogaritë bankare të saj, shumën e përcaktuar më sipër, brenda 90 ditëve nga data e rregjistrimit të shoqërisë në rregjistrin tregtar pranë QKB.

## Neni 6

Shoqëria fillon veprimtarinë e saj tregtare pas rregjistrimit të saj si person juridik dhe në rregjistrin tregtar pranë QKB.

Të ardhurat neto pas veçimit të fondevë si më sipër dhe shlyerjes së detyrimeve fiskale i mbeten për përdorim ortakëve të shoqërisë të cilët i ndajnë midis tyre në përputhje me vendimin e Asamblesë së ortakëve për caktimin e fitimeve.

Vendimi për caktimin e fitimeve (për shpërndarjen e fitimeve, për caktimin e rezervave apo mosshpërndarjen e fitimeve të vitit ushtrimor apo dhe fitimeve të mbartura), do të merret në çdo rast në mbledhjen përkatëse të asamblese së ortakëve të shoqërisë, me miratimin në mënyrë unanime me 100% të të gjithë kuotave të shoqërisë.

Asambleja e ortakëve mund të vendlodë që të shpërndahen shumat e fondevë të rezervuara duke treguar shprehimisht llojin e rezerves ku janë marrë.

Fitimet neto të realizuara nga veprimtaria e shoqërisë si dhe shumat e fondevë të rezervuara, do të përdoren lirisht nga ortakët/ortaku i saj. Ortakët/ortaku do t'i disponojnë lirisht fitimet neto të shoqërisë si dhe shumat e fondevë të rezervuara, pas vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, për shpërndarjen e tyre. Ortakët e shoqërisë nëpërmjet vullnetit të tyre të shprehur me shkrim, janë autoriteti i vetëm ligjor apo ekzekutiv, që vendlodë dhe vepron, në lidhje me caktimin e fitimeve neto të shoqërisë apo shumave të fondevë të rezervuara, për shpërndarjen ose jo të tyre, për investimin ose jo të tyre, si dhe për mënyrën e ndarjes së tyre midis ortakëve të shoqërisë.

Në çdo rast, dhe rast pas rasti, fitimet neto të shoqërisë apo shumat e fondevë të rezervuara, do të shpërndahen midis ortakëve të saj, në raportet që ortakët e shoqërisë, do të miratojnë në mënyrë unanime, me 100% të kotave të kapitalit të shoqërisë, pas analizave vjetore të aktivitetit tregtar dhe financiar të shoqërisë duke marrë në konsideratë edhe performancën e ortakëve në funksion të realizimit të fitimeve të shoqërisë, pavarësisht raportit të kuotave që ortakët kanë apo do të kenë në të ardhmen në shoqëri.

Ortakët e shoqërisë, nëpërmjet këtij statuti të shoqërisë, jepin miratimin e tyre të plotë dhe të parevokueshëm, për mënyrën e ndarjes së fitimit neto të saj, të përcaktuar si më sipër në këtë nen, duke hequr dorë dhe njëkohësisht duke humbur çdo të drejtë të tashme dhe të ardhme, për të pretenduar ndryshe nga sa është përcaktuar në të.

Cdo ortak ka të drejtën e transferimit jashtë vendit të pjesës së fitimit duke zbatuar dispozitat ligjore për këtë transferim.

## Neni 7

Organet drejtuese të shoqërisë janë: **Asamblea e Pergjithshme & Administratori** Asambleja e shoqërisë përbëhet nga Ortaku i vetëm i saj, dhe Administrator i shoqërisë është Z. Xhenis Mazreku.

Mënyra e formimit dhe funksionimi i këtyre organeve përcaktohen me statutin e shoqërisë.

### **Neni 8**

Ortaku/Ortakët detyrohen të ruajnë karakterin e fshehtësisë të gjithë dokumentacionit, informatave, etj. Duhet të merren masa të plota për të shmangur përhapjen e cdo të dhëne që ka të bëjë me shoqërinë dhe që vlerësohet si sekret tregtar në bazë të dispozitave ligjore në fuqi në vendin e ushtrimit të aktivitetit.

### **Neni 9**

Shoqëria mund të kryejë cdo veprim juridik që ka të bëjë me objektin e veprimitarisë së saj.

### **Neni 10**

Kjo kontratë lidhet për një periudhë kohe të pacaktuar. Ky afat mund të ndryshojë me vendim të organit kompetent në përputhje me statutin e shoqërisë dhe me dispozitat ligjore në fuqi.

### **Neni 11**

Dispozita të hollësishme për shoqërinë dhe funksionimin e saj përcaktohen në statutin e shoqërisë që i bashkangjitet dhe është pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

Mosmarveshjet që mund të lindin midis palëve në se nuk gjejnë zgjidhje me bisedime e mirëkuptim, do të zgjidhen në Gjykatën e Shkallës së Parë, Tiranë.

### **Neni 12**

Kjo kontratë u përpilua në katër kopje të njëjta në gjuhën shqipe duke depozituar kopjen në QKB për kryerjen e procedurave te rregjistrimit ne Rregjistrin Tregtar pranë saj, si dhe në cdo organ që kërkohet sipas ligjeve në fuqi.

Tiranë më, 27 Janar 2025.

**ORTAKU THEMELUS:**

**Xhenis Mazreku**

**Kristofor Harito**